

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe Gani Avdiu dhe Rustem Thaçi anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) Sh.A. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj R.B., kundër të paditurit B.B. nga Gjakova rr. “...” nr., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.165/10, të datës 25.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20.03.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e të paditurit B.B. nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.165/10, i datës 25.11.2013, **VËRTETOHET**, përveq pjesës për kamatën e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet me kamatë sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës, në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 25.11.2013, e deri në pagesën definitive.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.165/10, të datës 25.11.2013, në pjesën e parë të dispozitivit e ka detyruar të paditurin që brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në emër të borxhit për shërbimet e ofruara telefonike, t’ia paguaj paditëses shumën prej 97,41 euro, me kamatë 3.5%, të llogaritur nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarim 24.11.2009, e deri në pagesën definitive. Për shpenzimet procedurale nuk është vendosur ngase pala paditëse nuk i kishte kërkuar ato.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 24.11.2009, asokohe në Gjykatën Komonale në Gjakovë, paditësja në cilësinë e kreditorit fillimisht ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit autentik (faturave), kundër të paditurit në cilësinë e debitorit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori që në afatin prej 7 ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit t'a paguaj borxhin në shumën prej 97,41 euro, në kamat 3.5% duke e llogaritur atë nga data 24.11.2009, e deri në pagesën definitive të borxhit, së bashku me shpenzimet faktike të përmbarrimit të dhunshëm, në të kundërtën gjykata do të bëjë përmbushjen e ekzekutimit me dhunë, ashtu që sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit të regjistrohen, vlerësohen, të sekuestrohen dhe të shiten, e nëse debitori ushtron kundërshtim ndaj këtij aktvendimi, i njëjti do të konsiderohet padi, kurse në rast se pagesa e borxhit së bashku me shpenzimet është bërë brenda 8 ditësh, propozimi për ekzekutim do të tërhiqet.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me aktvendimin EKZ.nr.1794/09, të datës 24.11.2009, e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me pretendim se kreditori nuk e ka argumentuar borxhin e kërkuar me asnjë provë të vetme. Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të prapësimit të debitorit propozimin për përmbarrim të kreditorit e ka trajtuar si padi për fillimin e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.165/10, të datës 25.11.2013, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara tek kjo gjykatë dhe atë faturat e paditëses, në mënyrë të padyshimtë vërtetohet fakti se këtu i padituri për shfrytëzimin e telefonit të tij me nr.322 260, i ka borxh paditëses shumën në lartësi prej 97,41 euro, për çka edhe kjo gjykatë ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se ekziston detyrimi juridik civil i të paditurit ndaj paditëses, për borxhin në shumën e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimin i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimin është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është mjaft i

qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se borxhi është i një periudhe të gjatë kohore dhe si i tillë është parashkruar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, një pretendim i tillë nuk mund të paraqitet dhe të shqyrtohet në këtë fazë të procedurës, nga shkakku se i padituri nuk e ka paraqitur pretendimin e parashkrimit në gjykatën e shkallës së parë, kufizim ky i cili përcaktohet me dispozitën e nenit 180 paragrafi 3 i LPK-së, e i cili përcakton se *“prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenit 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar e drejta matariale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveq për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të kamatës dhe kohës së llogaritjes së saj, duke e gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë. 25.11.2013, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3265/14, me datë 20.03.2018**

**Kryetari i kolegjit**  
**Valon Totaj**